



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.242/4 Prot.

Tiranë, më 21 . 05. 2025

V E N D I M

Nr. 125, Datë 21. 05. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 245 Regj., datë 27.11.2024, të znj. M. B., përfaqësuar me autorizim nga z. I. Ç., (Drejtor i Përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Integritit të Jetimëve në Shqipëri), kundër Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “gjendjes shoqërore”, “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *Unë, M. B., jam një qytetare shqiptare me statusin ligjor të “Jetimit”, sipas ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, i cili garanton mbrojtjen dhe të drejtat për jetimët. Gjatë 33 viteve të punës si laborante teknike në QSUT “Shefqet Ndroqi”, kam dhënë kontribut të pandërprerë në një profesion që kërkon përkushtim, aftësi të specializuara dhe integritet profesional.*

Megjithatë, në prill të vitit 2021, kur shërbimi i laboratorit iu dha një subjekti privat përmes koncesionit, u vendosa përballë një zgjedhjeje të pamundur: të braktisja sigurinë e marrëdhënies time me shtetin ose të përballesha me pasiguri profesionale dhe financiare nga privati. E vendosur

¹Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

për të ruajtur stabilitetin tim dhe duke iu referuar të drejtave të mia ligjore, refuzova kontratën me subjektin privat.

Pas këtij vendimi, në vend që të më mbështesnin ose të më ofronin një zgjidhje të denjë për formimin tim profesional, drejtuesit e spitalit më pozicionuan në vende pune që jo vetëm nuk kishin lidhje me formimin dhe përvojën time, por ishin thellësisht fyese. Nga një laborante teknike me kualifikime dhe përvojë shumëvjeçare, u detyrova të punoj në lavanderinë e spitalit, një detyrë e respektuar ashtu si çdo profesion tjetër, por e papajtueshme me profilin dhe dinjitetin tim profesional. Kjo zhvendosje arbitrare, e pashoqëruar me ndonjë arsye objektive apo ligjore, më uli pagën dhe më privoi nga të ardhurat minimale për të mbajtur një jetë të thjeshtë por të dinjitetshme.

Ndërkohë, duke iu përkushtuar me përpjekje të jashtëzakonshme formimit tim, përfundova Fakultetin e Infermierisë, dega Laborator Klinik-Biokimik, në vitin 2024, duke plotësuar çdo kriter profesional për t'u rikthyer në profesionin tim. Pavarësisht kësaj, kërkesat e mia janë shpërfillur, edhe pse ka pasur dhe ka ende vende vakante për profilin tim. Kjo sjellje ka forcuar bindjen time se jam diskriminuar jo vetëm profesionalisht, por edhe socialisht, për shkak të statusit tim si jetime dhe mungesës së mbështetjes familjare.

Kjo padrejtësi ka pasur pasoja të thella mbi shëndetin dhe mirëqenien time. Përpos dëmit ekonomik nga ulja e pagës, kam vuajtur edhe emocionalisht dhe psikologjikisht. Të më trajtonin si një person të zëvendësueshëm dhe të pavlerë, duke më zhvendosur në pozita fyese, më ka rënduar aq shumë, sa shpesh më ka shkuar mendja drejt veprimeve drastike. Kam ndjerë izolim, përbuzje dhe një mungesë totale të respektit ndaj sakrificave dhe punës sime shumëvjeçare.

Kam bërë ankesa të shumta pranë institucioneve përkatëse, si drejtoria e spitalit dhe Ministria e Shëndetësisë, por çdo herë jam përballur me heshtje ose premtime boshe. Kjo më ka lënë me ndjesinë e një lufte të pabarabartë, ku vetëm sepse jam një njeri i vetëm, pa mbështetje, kam qenë viktimë e indifferencës dhe arrogancës institucionale.

Asnjë institucion shtetëror nuk ka të drejtë të më mohojë këtë mundësi apo të më trajtojë në mënyrë poshtëruese për shkak të statusit tim si jetime. Besoj se ndihma juaj mund të sjellë një zgjidhje për këtë padrejtësi që kam përjetuar dhe që ende po përjetoj.

5. Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- Rivendosja në detyrën e mëparshme si laborante teknike në QSUT “Shefqet Ndroqi”, në përputhje me arsimimin, kualifikimet dhe përvojën time 33-vjeçare.
- Verifikimi i shkeljeve të mundshme të ligjit mbi diskriminimin dhe mbrojtjen e statusit tim si jetime, bazuar në Ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996.
- Kompensim financiar për dëmin ekonomik dhe moral të shkaktuar nga pozicionimi i padrejtë dhe vendosjes në detyra që nuk kanë lidhje me formimin tim profesional.
- Urdhërimi i institucionit përkatës që të sigurojë respektimin e dinjitetit tim profesional dhe të eliminojë diskriminimin social e institucional ndaj personave me status jetime.

- Monitorim të vazhdueshëm për të garantuar që praktikat diskriminuese ndaj meje dhe rasteve të ngjashme të ndalohen dhe të mos përsëriten.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar², parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të këtij Ligji, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, si dhe ato çështje që janë brenda afatit kohor për shqyrtim sipas parashikimeve të LMD-së.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1585/2 prot., datë 05.12.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, si dhe dokumentacion provues, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Nëpërmjet shkresës me nr.465/3 prot., datë 17.12.2024³, Komisioneri është njohur me qëndrimin institucional të Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, përsa i takon pretendimit të ankueses znj. M.B., shkresë në të cilën, ndër të tjera, citohet se: *“Znj. M. B., pas përfundimit të kursit 1 (një) vjeçar si laborante Klinik-biokimik, ka punuar pranë institucionit tonë më datë 30.01.1989 po si laborante në laboratorin Klinik-Biokimik.*

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

³ Protokolluar pranë Komisi onerit me nr.1585/3 prot, datë 20.12.2024

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Megjithëse me arsim të mesëm profesional, znj. B. ka punuar në këtë pozicion deri më 09.07.2021, pasi shërbimi i laboratorit në S.U. “Shefqet Ndroqi” i kalon koncesionarit, duke marrë gjithë personelin ekzistues të laboratorit Klinik-Biokimik, pa lënë askënd të papunë nga konçensioni. Ashtu si edhe të tjerët, u njoftua edhe znj. Me. B., edhe pse figuronte me arsim të mesëm laborante klinike-biokimike, znj. B., refuzoi të kalojë pranë koncesionarit edhe pse nuk kishte arsimin përkatës.

Duke qenë se kishte statusin e jetimit dhe duke menduar që nga refuzimi zonja mbetej pa burim të ardhurash për të jetuar, u dakordësua dhe u pranua që më datë 09.07.2021 të punësohej në vendin vakant si punëtoare lavaxerie (referuar Vendimit nr. 11/185 prot., datë 09.07 dhe Kontratës nr. 48/1 prot., datë 09.07.2021).

Njëkohësisht, në vitin 2022 me ndryshimin e strukturës me Urdhërin nr. 3636 prot., dhe Kontratës nr. 26 prot., datë 01.02.2022, znj. M. B., emërohet “Specialiste/Operatore e Regjistrimit të të Dhënave Mjekësore”.

Do të donim t’ju bënim me dije se gjatë periudhës shkurt–shtator 2022, znj. M. B., sipas strukturës, është emëruar “Specialiste/operatore e sistemit të regjistrimit të të dhënave mjekësore”.

Duke mos ditur të përdorë në praktikë kompjuterin dhe as sistemin elektronik të pacientëve, pavarësisht asistencës së dhënë, si dhe duke krijuar problematika të shumta me pacientët dhe familjarët, nisur nga moskomunikimi etik — situata të cilat shpeshherë çonin në konflikte me pacientët — punonjësja ka kërkuar paraqitje në Drejtorinë e Përgjithshme dhe ishte dakord të largohej nga kjo detyrë, duke kërkuar edhe lehtësi për shkak të studimeve.

Ndërkohë, që me Urdhërin nr. 339, me nr. 13/257 prot., datë 19.09.2022, të nënshkruar me nr. 104 prot., datë 19.09.2022, znj. B. emërohet sanitare pranë institucionit, funksion të cilin nuk e ka kryer asnjë ditë deri më sot.

Nisur nga arsimi i kryer dhe me dakordësinë e znj. B., si dhe për shkak të mungesës së vendeve me arsim të mesëm (pasi QSRT është një institucion spitalor universitar dhe terciar, dhe ka pozicione të kufizuara për punonjës me arsim të mesëm), u bë emërimi i saj si sanitare. Pozicion pune që znj. B. nuk e ka ushtruar asnjë ditë, pasi gjatë këtyre viteve, ashtu si edhe sot, ajo asiston pranë Urgjencës së QSRT-së në përpunimin e analizave të ASTRUP-it (pozicion që nuk ekziston në strukturë, sepse analizat i kryen vetë makineria, por kemi caktuar znj. B., si punonjëse e jona, duke parë aftësitë e saj fizike, e cila nuk është e aftë të ushtrojë detyra të tjera të strukturave të reja të spitalit).

Njëkohësisht, me dashamirësinë e Drejtoreshës së SUSN, znj. B., është përkrahur gjatë gjithë kohës që ishte në punë, për të ndjekur edhe studimet universitare për laborante, dhe nuk ka punuar asnjë ditë në pozicionin e sanitares. Ajo nuk është detyruar asnjëherë të vijë në ditët e pushimit apo të festave, sepse znj. B., ka qenë gjithmonë problematike në sjellje me pacientët dhe jo-produktive në të gjitha detyrat funksionale të dhëna.

Po ashtu, nuk posedojmë asnjë diplomë universiteti për znj. B., për fushën e fizioterapisë apo gjuhës angleze. Njëkohësisht, ajo nuk ka asnjë eksperiencë trajnimi ose kurse në shkollë të Amerikës, dhe nuk di të komunikojë aspak në gjuhën angleze.

Gjatë këtyre viteve (2022–2024), pranë SUSN nuk është punësuar asnjë laborant, pasi nuk kemi më laborator Klinik–Biokimik, si pasojë e kalimit në konçesion.

Gjithashtu, do të donim të theksonim se zonja në fjalë, edhe gjatë gjithë kalimit me konçesion, nuk mundej kurrësi të konkurrenës si laborante, as te ne dhe as në ndonjë institucion tjetër, pasi nuk kishte arsimin përkatës (nuk kishte arsimin e lartë).

Znj. B. është pajisur me diplomën “Bachelor” si laborante në korrik të vitit 2024. Nga ky moment, zonjës i lind e drejta për të konkurruar dhe konkurimi realizohet vetëm nëpërmjet platformës elektronike “Infermierë për Shqipërinë”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me nr. 204, datë 09.04.2024, “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin përcaktohet:

Pika 1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin, emërimin, transferimin dhe disiplinën e profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në institucionet e kujdesit shëndetësor publik, nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”.

Pika 3. Në kuptim të këtij udhëzimi, institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor përfshijnë: spitalet universitare / terciare / rajonale / psikiatrike / bashkiake / qytetare / njësitë shëndetësore (këtu e më poshtë “NJVKSH”) / qendrat shëndetësore (këtu e më poshtë “QSH”) dhe institucionet qendrore në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që kanë në strukturat e tyre pozicionin “profesionistë të shkencave mjekësore teknike”.

Pika 6. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune, realizohen nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”.

Pika 7. Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vijim DQOSHKSH) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e procedurave të konkurimit dhe pranimin të profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në një vend të lirë pune në institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik dhe administron portalin “Infermierë për Shqipërinë”.

Kreu II — “Shpallja e konkurimit për profesionistë të shkencave mjekësore teknike dhe aplikimi”

Pika 4. Regjistrimi i kandidatëve bëhet vetëm nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”. Të interesuarit do të kenë si afat për kryerjen e aplikimit të paktën dy ditë kalendarike nga shpallja.

d. Nga të gjitha përcaktimet më lart dhe të tjera të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me nr. 204, datë 09.04.2024, “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në

institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike”, del në pah se në asnjë rast institucioni spitalor nuk mund të punësojë staf të profesioneve të shkencave mjekësore teknike, pasi çdo punësim kalon nga portali elektronik.

e. Si rrjedhim, znj. B., i lind e drejta të konkurrojë si të gjithë të diplomuarit e tjerë, përmes portalit, për ato institucione që kanë nevojë për laborantë.

f. Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” nuk mund të shkelë rregullat e punësimit, por me dashamirësinë e plotë e ka pranuar znj. M. B., për të punuar pranë institucionit tonë, duke i siguruar një pagesë si një burim i sigurtë jetese.

Ndërkohë, shtrimi i saj në spitalin tonë erdhi si pasojë e apendesitit (observim) dhe jo për sëmundje të lidhura me profesionin (bashkangjitur gjeni kopje të Formularëve të Cirkulencës). Ndërkohë, një person që sëmuret në profesion nuk kërkon me ngulm të punojë në të njëjtin institucion, duke e kërkuar me forcë dhe në shkelje flagrante të ligjit. Së fundmi, do të donim t’ju bënim me dije se: Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” nuk ka asnjë vend të lirë, përfshirë edhe pozicionet strukturore si “laborante”; si rrjedhim, Znj. B., mund të konkurrojë si të gjithë të diplomuarit e tjerë, pranë portalit, për ato institucione që kanë nevojë për laborantë, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të MSHMS, me nr. 204, datë 09.04.2024, për punësimin, emërimin, pezullimin, lirimin dhe disiplinën për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike.

Gjithashtu, në asnjë rast Znj. B., nuk është diskriminuar. Përkundrazi, si në institucion mjekësor dhe human në trajtimin dhe shërimin e jetëve të pacientëve, zonja është stimuluar dhe është përkrahur nga i gjithë stafi mjekësor/infermieror, si dhe nga titullarët e ndryshëm gjatë periudhave të ndryshme të drejtimit të QSRT “Shefqet Ndroqi”. Për të gjitha problematikat që mund të keni të paqarta, ju lutemi të paraqiteni ose të informoheni në mënyrë të hollësishme pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, për shqyrtimin e problematikave në lidhje me Znj. B.

Bashkëlidhur është dërguar dokumentacioni i cituar në shkresën së Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, kopje e dokumentacionit të dosjes personale të ankueses, si dhe dosjes personale të znj. M. B.

2. Me shkresën nr.1585/4 të Komisionerit i është përcjellë ankueses (Përfaqësuesit me autorizim nga z. I. Ç., (Drejtor i Përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Integritetit të Jetimëve në Shqipëri), shkresa nr.465/3 prot., datë 17.12.2024⁴ e Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, për të bërë parashtrimet e saja në lidhje me këto përgjigje. Referuar Fletës së Lajmërim-Marrjes të Zyrës Postare nr. RR723 743 345 AA, datë 24.12.2024, rezultoi se përfaqësuesi i ankueses e ka marrë në dorëzim shkresën nr.1585/4 të Komisionerit, por nuk ka dërguar asnjë përgjigje në lidhje me të pranë Komisionerit.

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1585/3 prot, datë 20.12.2024.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 242 prot., datë 03.02.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.
4. Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 25.05.2025, me praninë e subjektit ankues personalisht, Përfaqësuesit të ankueses me autorizim nga z. I. Ç., dhe përfaqësueses me autorizim⁵ të Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, znj. E. T., Drejtor i Drejtorisë së Manaxhimit të Çështjeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore pranë QSRT “Shefqet Ndroqi”.

Palët u qëndruan të njëjtave pretendime si ato të bëra të njohura shkresërisht në ankesën e parashtrimet e depozituara prej tyre para KMD-së.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, nga ana e Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, janë dërguar argumente dhe dokumentacion shtesë⁶, të cilat janë depozituar në dosje, në cilësi prove.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të LMD, si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se diskriminimi ka ndodhur, duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen në të drejtën për punësim;
- në krahasim me sesi janë trajtuar, trajtohen ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme, dhe;
- arsyeja për këtë trajtim është një/disa nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje ligjore nga diskriminimi.

⁵ Autorizimi nr.465/7 prot., datë 18.02.2025.

⁶ Shkresë e protokolluar pranë KMD-së me nr. 242/3 prot., datë 10.03.2025

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse pala ankuese është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me punonjës të tjerë të Qendrës Spitalore Universitare “Shefqet Ndroqi”, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet krahasuesi. Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien e saj të punësimit. Pra, për të vërtetuar sjelljen diskriminuese, nuk është e nevojshme në çdo rast identifikimi i një krahasuesi konkret, por kërkesa për të provuar se pala ankuese i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, konsiderohet e përmbushur edhe nga një krahasues “hipotetik”, që në rastin konkret është mënyra se si subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Qendra Spitalore Universitare “Shefqet Ndroqi”, ka respektuar standardet dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës së ankuses.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Punës, i ndryshuar⁷, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër, në këtë rast Qendrës Spitalore Universitare “Shefqet Ndroqi”, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej saj.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

⁷ Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkakun e pretenduar të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në të drejtën për punësim, në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve, rezulton se:

Ankuesja, znj. M. B., e datëlindjes 31.12.1968, banuese në qytetin e Tiranës, pretendon se është diskriminuar në marrëdhëniet e punësimit nga Qendra Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, për shkak të “gjendjes shoqërore”, “*përkatësisë në një grup të veçantë*” dhe “*çdo shkak tjetër*” të përcaktuar nga ligji.

Ankuesja ka mbaruar Shkollën e Mesme Teknologjike në vitin shkollor 1985-1986, në degën Ushqimore.

Më pas, në periudhën 01.09.1987 – 30.06.1988, ka marrë pjesë në kursin e kualifikimit njëvjeçar “Labororë-Klinike-Biokimike”, të organizuar nga Drejtoria e Kurseve të Kuadrove Mjekësore.

Sipas dokumentacionit të dosjes personale të vënë në dispozicion nga Qendra Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, rezulton se ankuesja është pajisur me diplomë njëmujore për trajnimin e saj në lidhje me pjesëmarrjen në kursin e kompjuterit.

Gjithashtu, rezulton se ankuesja është pajisur edhe me leje për ushtrimin e profesionit si teknike laborator, lëshuar nga Urdhëri i Infermierit të Shqipërisë.

Referuar Vërtetimit datë 30.08.2024 të Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, vërtetohet se znj. M. B., ka përfunduar studimet e Ciklit të Parë “Bachelor”, me kohë të plotë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike Tiranë, në Programin e studimit “Teknike Laboratori”, gjatë viteve akademike **2023-2024**.

Sipas Librezës së Punës, rezulton se znj. M. B., ka filluar punë më datë 30.01.1989, me detyrën “Laborante”, pranë Spitalit Senatorium, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 09.07.2021.

Nga data 09.07.2021 deri 01.02.2022, znj. M. B., ka mbajtur pozicionin e “Punonjëse lavanderie”. Ndryshimi i pozicionit të punës të znj. M. B., ka ardhur si rezultat i zbatimit të Urdhërit nr. 635, datë 03.09.2019, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me objekt: “Përmbushjen e detyrimeve të kontratës koncesionare nr. 19242, datë 10.04.2019, për ‘Ofrimin e Shërbimeve Laboratorike të spitaleve Universitare, Rajonale dhe atyre Bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës’”.

Pra, shërbimet laboratorike të Qendrës Spitalore Universitare “Shefqet Ndroqi” (*ish Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”*) i janë kaluar koncesionarit.

Ndërkohë, referuar akteve administrative të vëna në dispozicion, rezulton se ka patur një korespondencë me koncesionarin për punësimin e personelit ekzistues të laboratorit Klinik-Biokimik, me qëllim që të mos lihen asnjë nga punonjësit pa punë.

Gjithashtu, rezulton dhe një korespondencë shkresore me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku përmes kësaj shkresë u kërkua punësimi i personelit që nuk pranoi të kalonte tek koncesionari, midis të cilëve edhe znj. M. B.

Me shkresën nr. 1449/3 prot., datë 07.05.2021, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndër të tjera janë dhënë orientimet për rastet kur ka mungesë të vendeve vakante për laborantët klinik-biokimik, për përshtatjen e arsimit dhe kriterëve të punonjësve, të merren masat ligjore, duke respektuar afatet e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe duke i atribuar çdo punëmarrësi të gjitha të drejtat që parashikon legjislacioni në fuqi.

Ndërkohë, me miratimin e strukturës me nr. 133/23 prot., datë 13.01.2022, *“Për miratimin e strukturës së Spitalit Universitar ‘Shefqet Ndroqi’”*, në bazë të Urdhërit nr. 01.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit, është urdhëruar: *Duke nisur nga data 01.02.2022, dhe duke u përshtatur sipas strukturës së re organizative, emërohet Specialist/operator i sistemit të Regjistrimit të të Dhënave Mjekësore znj. M. B.*

Këtë pozicion znj. M. B., e ka mbajtur deri në datën 19.09.2022, ku në bazë të Urdhërit nr. 339, datë 19.09.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit, ka kaluar në detyrën e sanitares në përputhje me strukturën e re organizative.

Në bazë të Urdhërit nr. 774, datë 29.12.2023, të Ministrit përgjegjës për Shëndetësinë, *“Për miratimin e strukturës dhe Rregullores së Përgjithshme të Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës ‘Shefqet Ndroqi’”*, është miratuar struktura dhe kriteret përkatëse për secilin pozicion, pasi Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” është quajtur tashmë Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës ‘Shefqet Ndroqi’.

Në bazë të Urdhërit nr. 321, datë 29.12.2023, *“Për emërimin e punonjësve/sanitarëve në sektorin e shërbimeve të përgjithshme”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Spitalore Rajonale e Tiranës ‘Shefqet Ndroqi’, është urdhëruar emërimi i znj. M.B., në pozicionin e sanitares.

- **Lidhur me pretendimin për diskriminim ardhur si rezultat i pozicionimit të ankueses si sanitare në datën 09.07.2021.**

Bazuar në aktet e vëna në dispozicion rezultoi se:

Në zbatim të Urdhërit nr. 635, datë 03.09.2019, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me objekt: *“Përmbushjen e detyrimeve të kontratës koncesionare nr. 19242, datë 10.04.2019, për ‘Ofrimin e Shërbimeve Laboratorike të spitaleve Universitare, Rajonale dhe atyre Bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës’*, shërbimet laboratorike të Qendrës Spitalore Rajonale e Tiranës *“Shefqet Ndroqi” (ish Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”)* i janë kaluar koncesionarit.

Në datën 09.07.2021, znj. M. B., ka lidhur Kontratën Individuale të Punës nr. 48/1 prot., me Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, për pozicionin e *“Punonjëse lavanderie”*, kontratë e cila rezulton të jetë firmosur nga ankuesja.

Nga data 01.02.2022, duke u përshtatur sipas strukturës së re organizative, ankuesja është emëruar Specialist/operator i sistemit të Regjistrimit të të Dhënave Mjekësore. Znj. M.B., ka lidhur Kontratën Individuale të Punës nr. 26 prot., datë 01.02.2022, me Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” kontratë e cila rezulton të jetë firmosur nga ankuesja.

Më pas në bazë të Urdhërit nr. 339, datë 19.09.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit, ka kaluar në detyrën e sanitaresh në përputhje me strukturën e re organizative. **Në datën 19.09.2022**, znj. M. B., ka lidhur Kontratën Individuale të Punës nr.104 prot., datë 19.09.2022, me ish-Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, për pozicionin e “Sanitare”, kontratë e cila rezulton të jetë firmosur nga ankuesja.

Referuar të dhënave të Formularit të ankesës, znj. B., ka shënuar si kohë kur ka ndodhur diskriminimi datën **01.04.2021** dhe kohën për marrjen dijeni të diskriminimit datën **01.04.2021**.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se momenti i marrjes dijeni nga ankuesja mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar nga Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” (*ish Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”*) të provuar në aktet administrative të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës së **znj. B.**, rezulton të jetë data **09.07.2021**, kohë e cila korespondon me nënshkrimin e Kontratës Individuale të Punës nr. 48/1 prot., lidhur midis ankueses me Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, kontratë e cila rezulton të jetë firmosur nga ankuesja ndërsa data e depozitimit të ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është **27.11.2024**.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit daton më shumë se 3 (vjet) nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar. Njëkohësisht, edhe momenti, i marrjes dijeni mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 245, datë 27.11.2024 pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji” dhe pikën 4/dh të tij, ku është parashikuar se: “Ankesa nuk pranohet kur paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet”. Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

- **Lidhur me pretendimin për diskriminim në lidhje me kërkesën e datës 26.07.2024 për pozicionimin e ankueses si laborante.**

Sikurse parashtruam më lart, në bazë të ndryshimeve strukturore të fundit të bëra nga Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës ‘Shefqet Ndroqi’, në zbatim të të Urdhërit nr. 321, datë 29.12.2023, “Për emërimin e punonjësve/sanitarëve në sektorin e shërbimeve të përgjithshme”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Spitalore Rajonale e Tiranës ‘Shefqet Ndroqi’, është urdhëruar emërimi i znj. M. B., në pozicionin e sanitaresh.

Ndryshimi i pozicionit të punës të znj. M. B., nga laborante në sanitare ka ardhur si rezultat i zbatimit të Urdhërit nr. 635, datë 03.09.2019, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me objekt: “Përmbushjen e detyrimeve të kontratës koncesionare nr. 19242, datë 10.04.2019, për ‘Ofrimin e Shërbimeve Laboratorike të spitaleve Universitare, Rajonale dhe atyre Bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës’”. Shërbimet laboratorike të Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi” (ish Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”) i janë kaluar koncesionarit.

Znj. M. B., ishte informuar, ashtu si edhe të tjerët, për mundësinë e punësimit pranë koncesionarit si laborante, megjithëse, ajo kishte arsimin e mesëm dhe ishte diplomuar si laborante klinike-biokimike.

Sipas strukturave të reja organizative dhe kërkesave për pozicionin e laboratorëve në Qendrën Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”, pozicioni i laborantes ishte parashikuar të ishte për individë me arsim të lartë, dhe jo për ata që kishin vetëm arsimin e mesëm. Edhe pse znj. B., kishte përvojë si laborante, ajo nuk përmbushte kriterin e arsimit të lartë të kërkuar nga struktura e re.

Për pasojë, znj. B., refuzoi të kalonte tek koncesionari për këtë pozicion, ndërkohë që pozicionet e tjera që mund të ishin të përshtatshme për arsimin e mesëm që ajo dispononte, në Qendrën Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” (ish Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”) i takonin profileve të ndryshme pune që nuk lidhen me pozicionin e laborantes.

Sikurse u vu në dukje gjatë seancës dëgjimore të datës 25.02.2025, si dhe nga përgjigja zyrtare e dhënë nga Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” (ish Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”), fakt i cili nuk u kundërshtua nga znj. B., rezultoi se, pavarësisht se ishte emëruar në pozicionin e sanitares, ajo nuk e ka kryer këtë funksion asnjë ditë.

Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” (ish Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”) është shprehur se: “Nisur nga arsimi i kryer, me dakordësinë e znj. B., dhe duke marrë parasysh vendet vakante për punonjës me arsimin e mesëm (pasi QSRT është një institucion spitalor universitar dhe terciar dhe ka pozicione të kufizuara për arsimin e mesëm), u bë emërimi në pozicionin e sanitares.

Megjithatë, znj. B., nuk e ka ushtruar këtë pozicion asnjë ditë. Gjatë këtyre viteve, ashtu si dhe sot, ajo asiston pranë Urgjencës të QSRT në marrjen dhe përpunimin e analizave të ASTRUP-it (pozicion që nuk ekziston në strukturën e spitalit, pasi analizat i kryen vetë makineria). Kjo ka ndodhur për shkak të dashamirësisë për ta ndihmuar, duke marrë parasysh aftësitë fizike të saj, të cilat nuk e lejojnë të ushtrojë detyrat që parashikohen nga strukturat e reja të spitalit.”

Referuar Vërtetimit datë 30.08.2024 të Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, vërtetohet se znj. M. B., ka përfunduar studimet e Ciklit të Parë “Bachelor”, me kohë të plotë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike Tiranë, në Programin e studimit “Teknike Laboratori”, gjatë viteve akademike 2023-2024.

Qendra Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, është shprehur në seancën dëgjimore të datës 25.02.2025 se, nga znj. M. B., ende nuk është dorëzuar ndonjë diplomë e arsimit të lartë pranë Burimeve Njerëzore të kësaj qendre.

Ndërkohë, rezulton se nga ana e ankueses janë bërë kërkesa për pozicionimin e saj si laborante, në bazë të arsimit të lartë dhe kualifikimeve të saj, ku kërkesa e fundit mban datën 26.07.2024.

Ankueses i është kthyer përgjigje në lidhje me këto kërkesa dhe është sqaruar zyrtarisht. Po ashtu, lidhur me këtë shqetësim, ajo i është drejtuar edhe Avokatit të Popullit, i cili, me shkresën nr. R1/M 21-5 prot., datë 21.01.2025, i ka përcjellë të njëjtat sqarime dhe është vënë në dijeni për kushtet dhe rrethanat që lidhen me çështjen e saj.

Referuar përgjigjeve të kthyer ankueses për emërimin e saj si “laborante” dhe përgjigjes zyrtare të kthyer Komisionerit, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” është shprehur se:

Gjatë këtyre viteve (2022-2024), pranë SUSN nuk është punësuar asnjë laborant, pasi ne nuk kemi më laborator Klinik-Biokimik, si pasojë e kalimit në konçension. Gjithashtu, do të donim të theksonim se zonja në fjalë, edhe gjatë kalimit të laboratorit në konçension, nuk mundej kurrsesi të konkurronte si laborante, as te ne dhe as në ndonjë institucion tjetër spitalor, pasi nuk kishte arsimin përkatës (nuk kishte arsimin e lartë).

Znj. B. është pajisur me diplomën Bachelor si laborante në korrik të vitit 2024. Nga ky moment, zonjës i lind e drejta për të konkurruar dhe konkurrimi realizohet në portalin “Infermierë për Shqipërinë”, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me nr. 204, datë 09.04.2024, “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike”.

Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin, emërimin, transferimin, pezullimin, lirimin dhe disiplinën e profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik, nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”. Në kuptim të këtij udhëzimi, institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik universitare spitalore përfshijnë: terciare, rajonale, psikiatrike, bashkiake, ditore, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor (NJVKSH), qendrat shëndetësore (QSH), si dhe institucionet qendrore në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që kanë në organikat e tyre pozicionin “profesionistë të shkencave mjekësore teknike”.

Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”. Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (DOOSHKSH) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e procedurave të konkurrit dhe të pranimit të profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në një vend të lirë pune në institucionet e kujdesit shëndetësor publik dhe administron portalin “Infermierë për Shqipërinë”.

Regjistrimi i kandidatëve bëhet vetëm nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”. Të interesuarit do të kenë si afat për kryerjen e aplikimit të paktën dy javë kalendarike nga data e shpalljes.

Nga të gjitha përcaktimet më sipër, si dhe nga të tjera të përfshira në udhëzimin e mësipërm, del në pah se në asnjë rast institucioni spitalor nuk mund të punësojë staf të profesioneve të shkencave mjekësore teknike jashtë procedurës përmes portalit elektronik.

Si rrjedhim, znj. B., i lind e drejta të konkurrojë si të gjithë të diplomuarit e tjerë, pranë portalit, për ato institucione që kanë nevoja për laborantë. Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” nuk mund të shkelë rregullat e punësimit, por me dashamirësi të plotë e ka pranuar znj. M. B., për të punuar pranë institucionit dhe për të marrë një pagesë si një burim i sigurt jetese.

Së fundmi, ju bëjmë me dije se Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” nuk ka asnjë vend vakant me arsim të lartë, përfshirë edhe pozicionet strukturore si “laborante”. Si rrjedhim, znj. B., i lind e drejta të konkurrojë, si të gjithë të diplomuarit e tjerë, pranë portalit për ato institucione që kanë nevoja për laborantë, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. 204, datë 09.04.2024.

Më datë 13.01.2025, ju zhvilluat një takim me ekspertin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Drejtoreshën Juridike dhe të Burimeve Njerëzore të spitalit, ku u ballafaquat me përgjigjen dhe ankesën e ngritur nga ana juaj. Ju dëgjuat dhe bashkëbiseduat mbi situatën tuaj dhe angazhimin e këtij institucioni ku punoni prej vitesh, i cili brenda mundësive ju ka ndihmuar dhe mbështetur. Sa i takon sistemimit të pozicionit si laborante, ju u informuat që nuk ka vende vakante dhe se do të asistoheni nga ky institucion për të aplikuar në portal lidhur me pozicionet që do të hapen nga Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Sa më sipër, detyrat dhe kompetencat e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe organeve në varësi përcaktohen nga VKM-ja nr. 419, datë 04.07.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”.

Në Kreun III, pika 8/ç të këtij vendimi, përcaktohet se:

“8. Drejtoritë rajonale kryejnë detyrat si më poshtë vijon:

...ç) Kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndetin publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi, trajnimi, etj) për rajonin përkatës”.

Procedurat për punësimin e punonjësve specialist deri titullar institucioni në drejtorinë qendrore të OSHKSH, drejtoritë rajonale të OSHKSH, në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, si dhe në administratën e spitaleve rajonale e bashkiake rregullohen sipas Udhëzimit me nr. 204, datë 09.04.2024, “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike”.

Në Kreun I, pika 1, parashikohet se: “1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin, emërimin, transferimin, pezullimin, lirimin dhe disiplinën e profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në

institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik, nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë””.

6. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Infermierë për Shqipërinë”. 7. Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim DQOSHKSH) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e procedurave të konkurrimit dhe të pranimi të profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në një vend të lirë pune në institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik dhe administron portalin “Infermierë për Shqipërinë”.

Shpallja e vendeve të lira të punës dhe aplikimi parashikohen në Kreun II të këtij udhëzimi, në të cilin përcaktohet se:

“1. Institucionet shëndetësore publike në varësi të OSHKSH-së identifikojnë vendet e lira të punës që krijohen dhe raportojnë sipas varësisë hierarkike pranë DROSHKSH, DQOSHKSH ose MSHMS.

2. Shpallja e vendeve vakant bëhet në faqen zyrtare të DQOSHKSH, për pozicionet që janë emërtesë e ministrit dhe në faqen zyrtare të MSHMS. Gjithashtu shpallja bëhet dhe në faqen e internetit të institucionit, në rast se kanë të tillë.

3. Shpallja përmban kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pranimin, fushën e njohurive, dokumentet që duhet të dorëzohen, afatin e dorëzimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe mënyrën e komunikimit të vlerësimit”.

Në Kreun IV, pika 1, germa g) përcaktohet se:

“1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë sipas autoritetit që bën emërimin, miratohet si më poshtë:

...e) Për emërimet në pozicionin shef shërbimi dhe pozicionet e tjera të administratës në spitalet rajonalë/bashkiak, Komisioni krijohet nga DROSHKSH, kryetar i Komisionit është titullari i spitalit rajonal/bashkiak;

ndërsa në pikën 2 përcaktohen detyrat komisionit të vlerësimit si më poshtë:

- a) administron dosjet e aplikantëve;
- b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;
- c) përgatit pyetjet me shkrim;
- d) bën intervistimin e kandidatëve;
- e) bën njoftimin e kandidatëve për pikët e vlerësimit;
- f) dërgon procesverbalet dhe materialet e tjera të konkurimit pranë njësisë së burimeve njerëzore;
- g) dërgon tek autoriteti përgjegjës për emërimin e kandidatit fitues dhe një kopje të procesverbalit...”

Në shtojcën 1, të kësaj VKM-je, pasqyrohet tabela me kriteret e vlerësimit të dosjes për kandidatët, si më poshtë:

Nr.	Treguesi dhe kriteret	Pikët
-----	-----------------------	-------

1.	Përvojë pune në profesion (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite eksperiencë pune)	1 - 10 pikë
2.	Nota mesatare e studimeve të larta, Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 6.00 = 2 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 7.00 = 4 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 8.00 = 6 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 9.00 = 8 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 10.00 = 10 pikë	1 -10 pikë
3.	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja të mbrojtura maksimumi = 4 pikë	0 – 4 pikë
4.	Studime shtesë deri në 4 pikë; Master profesional – 1 pikë; Master shkencor – 2 pikë; Diplomë shtesë – 4 pikë	0 – 4 pikë
5.	Trajnime dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën – maksimumi 2 pikë; a) Trajnime dhe kualifikime me kohëzgjatje dy javë deri në tre muaj – 1 pikë; b) Kualifikime nga 3 muaj e më shumë – 2 pikë	0 -2 pikë

Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i OSHKSH-ve, rregullohet sipas parashikimeve të bëra në “Rregulloren e Brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor”, të miratuar me Urdhrin nr. 18, datë 17.01.2019 të MSHMS.

Në nenin 14, shkronja d), të kësaj Rregulloreje, përcaktohet se, Drejtoritë Rajonale kanë si detyrë: “... d) Të kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndet publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi, trajnimi, etj) për rajonin përkatës.”

Në nenin 19 të kësaj rregulloreje përcaktohet se:

“1. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e DROSHKSH është përgjegjëse për funksionet dhe detyrat e financave, shërbimeve juridike dhe shërbimet e përgjithshme mbështetëse”, ndërsa në pikën 3 të këtij neni përcaktohen detyrat e Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të cilat janë:

a) Menaxhimi i çështjeve që lidhen me burimet njerëzore në institucionet shëndetësore të rajonit.
b) Identifikon nevojat për rekrutim për personelin mjekësor dhe stafin tjetër të të gjitha institucioneve shëndetësore të rajonit.

...

e) Organizon procedurën e rekrutimit sipas udhëzimeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për pozicionet e tjera në institucionet shëndetësore”.

Në këtë kontekst, Komisioneri vëren se:

- Znj. M. B., është informuar për ndryshimin e strukturës së shërbimit laboratorik si dhe për pamundësinë për të vijuar në pozicionin e mëparshëm si laborante, për shkak të mungesës së arsimit të lartë në atë kohë.
- Qendra e ka emëruar znj. B., në pozicionin e sanitaresh, me dakordësinë e saj, duke marrë parasysh nivelin arsimor të asaj kohe dhe mundësitë reale të sistemimit.
- Pavarësisht emërimit, znj. B., nuk e ka ushtruar pozicionin e sanitaresh, por është lejuar të asistojë në Urgjencë në mënyrë vullnetare, në shenjë mirëkuptimi dhe ndihme nga institucioni.
- Pas përfundimit të arsimit të lartë në korrik 2024, znj. B., është informuar se duhet të aplikojë për pozicionin e laborantes përmes portalit “*Infermierë për Shqipërinë*”, në përputhje me udhëzimin përkatës të MSHMS.
- Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”, i ka kthyer përgjigje zyrtare ankueses dhe e ka sqaruar për mungesën e vendeve vakante dhe për procedurat e punësimit, ndërsa e ka mbështetur në vijimësi për t’u orientuar drejt aplikimeve përmes portalit elektronik.

Referuar rrethanave të paraqitura dhe ndryshimeve të ndodhura gjatë viteve të fundit, pavarësisht përvojës së gjatë të ankueses znj. M. B., në pozicionin e laborantes, ndryshimi i strukturës së Qendrës Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, si dhe transferimi i shërbimeve laboratorike tek një operator koncesionar në zbatim të Urdhrit nr. 635, datë 03.09.2019 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, solli jo vetëm zhvendosjen e këtij shërbimi jashtë strukturës së spitalit, por edhe ndryshimin e kriterëve për pozicionin përkatës.

Si pasojë, në strukturën e re të Qendrës Spitalore Rajonale “Shefqet Ndroqi” nuk parashikohej më pozicioni i laborantit si pjesë e organikës së saj, dhe të gjitha funksionet laboratorike kaluan në kompetencën e koncesionarit. Paralelisht, në përputhje me standardet e reja profesionale dhe kërkesat për kualifikim, pozicioni i laborantit tashmë kërkonte detyrimisht arsim të lartë. Në këtë kohë, znj. B., nuk i përmbushte më këto kriterë arsimorë, për pasojë nuk mund të vazhdonte në pozicionin e mëparshëm.

Për rrjedhojë, ajo nuk mund të vijonte të ushtronte funksionin e mëparshëm, dhe në mungesë të vendeve të tjera të përshtatshme sipas arsimit që zotëronte, në zbatim të Urdhrit nr. 321, datë 29.12.2023, ajo u emërua në pozicionin e sanitaresh me dakordësinë e saj.

Ndërkohë, në korrik të vitit 2024, pas përfundimit të studimeve “Bachelor” në Teknikë Laboratori, znj. B., ka fituar të drejtën për të konkurruar për pozicionin e laborantes vetëm përmes platformës elektronike “*Infermierë për Shqipërinë*”, në përputhje me Udhëzimin nr. 204, datë 09.04.2024 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila përcakton si rrugë të vetme të rekrutimit procedurën përmes këtij portali.

Në përfundim, nga analiza e dokumentacionit dhe rregullimeve përkatëse ligjore, rezulton se veprimet e ndërmarra nga Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi” kanë qenë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe të motivuara nga ndryshimet objektive të strukturës funksionale të institucionit. Institucioni ka vepruar në mënyrë të kujdesshme dhe në

përputhje me detyrimet e tij, duke respektuar si rregullat e rekrutimit ashtu edhe të drejtat e punonjëses, nuk ka patur veprime të padrejta, të pafavorshme apo të paligjshme lidhur me sa ka pretenduar ankuesja.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Në nenin 12/1/c) të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara nuk rezultoi se ankuesja është vendosur në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme nga ana e Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës *“Shefqet Ndroqi”*, sa i përket trajtimit të saj gjatë marrëdhënieve të punësimit, krahasuar me kolegë të tjera të cilat ndodhen në kushte të njëjta me të.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, nga ana e Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës *“Shefqet Ndroqi”*, lidhur me trajtimin të saj gjatë marrëdhënieve të punësimit.

Në mungesë të trajtimimit të padrejtë e të pafavorshëm të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm të tij, të lidhur domosdoshmërisht me *“shkakun”* e pretenduar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, znj. M. B., në fushën e punësimit, nga ana e Qendrës Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”, për shkak të të “*gjendjes shoqërore*”, “*përkatësisë në një grup të veçantë*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA